REPUBLIKA E KOSOVËS
/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI/ BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr 289/2013

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE,** Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesit; nga te cilin perfaqson Avokat; nga pas autorizimit me shkrim, kunder te paditures; te cilen e perfaqson Avokati Publik Komunal baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 500,oo Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.30.01.2014 jep kete;

## AKTGJYKIM

I- **APROVOHET** kerkespadia e paditeses dhe **VERTETOHET** se Paditesja nga eshte shfrytzuese e perhershme e pjeses se parc kat. nr. me kultur Rruge e pakategorizuar, ne vendin e qujtur, " ",, me siperfaqe S= me masa dhe kufi qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes e cila evidentohet ne emer Kuvendi Komunal 1/1 ZK- Mitrovice. e ne baze te dhenjes ne shfrytzim te perhershem nga ana e te paditures qe nga 28.01.1987.

II- **DETYROHET** e paditura qe ti njoh kete te drejte paditeses dhe te lejoje qe paditesja kete palujtshmeri ta regjistroje ne emer te saje prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovice ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

-Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

## Arsyetim

Paditesja ne padin e parashtruar si dhe ne seancat e mbajtura nepermjet te autorizuarit tesaje ka theksuar se ; paditesja ne baze te aktvendimit te paditures- nr.

dt 28.01.1987 i eshte dhene ne shfrytzim te perhershem parc. kat.
dhe me sip.te pergjithshme e cila gjendet ne Rr. .

Ne baze te Aktvendimit te paditures , nr. dt. 25.04.1988 , paditesja ka ndertuar shtepine ne te cilen ka jetuar deri ne vit. 1999.

Ne seancen e shqyrtimit i autorizuari i saje dheksoi se kete palujtshmeri paditsja e shfrytzon qe nga vit. 1950 ku edhe ka jetuar me familje e njohur si Lagja e Kokeriqve. Mirepo e njejta ne vit 1986 ka parashtruar kerkese per rregullimin e qeshtjeve pronesore dhe e paditura me vendimin Nr. dt 20.04.1986 i ka dhene ne shfrytzim te perhershem ngastrat kat. dhe me qellim te njesise ndertimore te ndertimit te shtepise se banimit. E paditura ne baze te drejtes se perparsise se ndertimit me 1987 i ka dhene lejen ndertimore paditeses. Si baze per legalizimin dhe ndertimin e shtepise nga e paditura eshte bere protokoli mbi plotsimin e planit urbanistik total per ngastrat dhe . Pasi qe paditesja i ka plotsuar te gjitha kushtet ne vit 1977 ka parashtruar kerkese te paditures per regjistrimin e kesaje palujtshmerie prane Drejtoride per Gjeodezi ne dhe ky Organ me aktvendimin . Nr. dt 12.12.1997 me te cilin ngastrat kat. te cilat jane objekt shqyrtimi jane regjistruar ne emer te paditeses. Mirepo pasi qe ky regjistrim eshte bere ne vit. 1977 Drejtoria e Gjeodezise posedon dokumentacionin katastral mbi ndarjen e ktyre ngastrave deri ne vit. 1996, prandaje kto ngastra nuk ka munsdur qe ti zbatoi duke i regjistruar ne emer te paditeses,

Ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padin dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi

Perfaqsuesi i te paditures ne pergjigjje te padise dhe kerkespadise theksoi se; epilogu i qeshtjes kontestuese qe procedohet duhet te jete rezultat i provave te administruara.

Shpenzimet e perocedures kontestmore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Aktvendimet e te paditures ;Nr. dt 20.05.1986, Nr. dt. 28.01.1987, Nr. dt 02.04.1988, Nr. dt 18.04.1988. Certifikaten e pronesise P. dt 13.03. 2013, lexoi Proqesverbalin mbi vendshiqim te kesaje gjykate C. 17. 12. 2013, lexoi ekspertzen gjeodete te ekspertit gjeodet; dt.24.12.2013, beri veshtrimin ne skicen e terenit nga i njejtit ekspert, beri veshtrimin ne situacionin e terenit dt. 09.02.1998 si dhe plotsimin e Planit urbanistik vit. 1986 dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga aktvendimet e sipercekura te paditures konstatohet se; ne kerkese te
:s e paditura me vendimet e saje te sipercekura i ka dhene ne shfrytzim te
ıem paditeses, token ndertimore parc. kat. , ZK- ne sip.
ha, si shfrytzuese e mehershme e cila ka te drejten e perparsise se shfrytzimit te
ndertimore , sipas te drejtes se perparsise se ndertimit dhe i eshte lejuar ndertimi
ıal i nderteses per banim ne perdorim te perhershem me gabarite [ 10x 10 m].ne
t dhe ne pjesen e parc. ne vendin e qujtur

Nga Certifikatat mbi te drejtat e pronese se palujtshme te cekur me larte
ɔhet se parc. kat. , evidentohen ne emer te paditures.

Nga proqesverbali mbi vendshiqim i kesaje gjykate i cekur me larte, konstatohet
qtari me vrojtim te drejperdrejt ne vend, konstatohet se palujtshmeria kontestuese
Perendimore kufizohet me rrugen urbane, ne anen Jugore me rrugen dytesore.
eshte e kufizuar me rrjet teli dhe me bagrema te vjeter. Ne pjesen Lindore dhe
ıdore kufizohet me shtepi private. Me heret ka egzistar 1- shtepi perdhese banimi
tani eshte ne ndertim e siper I-objekt afarist banesor.
Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me larte konstatohet se
ıatjeve te kryera te parc kontestuese , ka vertetuar se palujtshmerine kontestuese
ıe pjesa e parc. kat e cekura ne dispozitiv me masa dhe kufinje te shenuara si ne
zen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit, te cilat jane pjese perberse te
zes dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.
Eksperti ne fjale ka konstatuar se ne baze ta dokumentacionit te prezentuar nga
a; vendimit mbi dhanjen e tokes ndertimore, dt 28.01. 1987 ku jane
a parc. , pase shiqimit ne planet e D.GJ.K.P, parc me nr.
ıet me parc. pasi qe parc. eshte rruge. Mirepo parc. lidhet
e qe shihet eshte ne plotsim detal urbanistik ku eshte e cekur parc.

Nga Skica e terenit shifet shtrirja, perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmeris
lore e te cekur ne dispozitiv te aktgjykimit..

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim
statoi se patundshmerin tani lendore paditesja e ka ne disponim dhe shfrytzim te
nga viti 1986, kur e njejta i eshte dhene ne shfrytzim nga e paditura, sipas
imit .. 20.05.1986 dhe aktvendimit dt 28.01. 1987,dhe
esja ne kete palujtshmeri tani lendore ka ndertuar shtepin per banim dhe kete
meri e ka shfrytzuar pa pengesa qe nga ather e gjere me tani.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr.
i4, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne
ı te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret qe nga vit 1986, paditesja e ka pasur ne shfrytzim dhe
n te lire kete palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush.

Prandaj ne anen e paditeses ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i kesaje palujtshmerie.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditeses kjo palujtsheri i eshte ndare-dhene ne shfrytzim te perhershem nga e paditura si pronare e saje. .

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesja kete palujtshmeri e ka ne disponim faktik, qysh para vitit 1986.

Gjithashtu nga moment i dhenjes ne shfrytzim, paditesja ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie lendore gjer me tani. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre- derivative- me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 te LPK,

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C nr 289/2013 dt. 30.01.2014.

**G j y q t a r i,**
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves ne Prishtine e permes kesaje gjykate.